

### Shtojca 1. Rregullat e ankandit për obligacionet referencë (benchmark)

1.	Shpallja e të dhënave të ankandit (ISIN, shuma) 1 javë kalendarike përpara ankandit. Konfigurimi i të dhënave të ankandit në sistemin AFISaR do të jetë i hapur për marrjen e porosive dy ditë pune përpara ankandit.
2.	Vetëm Zhvilluesit e Tregut mund të vendosin kërkesa për llogari të tyre apo klienteve.
3.	Përfundimi i vendosjes së kërkesave pjesëmarrëse në ankand është deri në orën 10 të datës së zhvillimit të ankandit.
4.	Ankandi i obligacioneve referencë zhvillohet si ankand me shumë çmime.
5.	Të gjithë ofertuesit e tjerë paraqiten nëpërmjet Zhvilluesve të Tregut . Zhvilluesit e Tregut janë të detyruar t'i paraqesin porositë e klientëve në ankand me një tarifë jo më të madhe se 0,7 % e vlerës nominale të porosisë së klientit.
6.	Nuk ka kufizim mbi numrin e kërkesave të vendosuar nga Zhvilluesit e Tregut .
7.	Për të shmangur gabimet njerëzore në vendosjen e kërkesave, kërkesë larg vlerës së tregut konsiderohen ato që janë +/- 90 pikë bazë nga përcaktimi i <i>yield</i> -it fiks të ditës së mëparshme. Kërkesat që bien në këtë kategori (pra, larg tregut) përjashtohen nga përllogaritja e rezultatit të ankandit. Në rast të një gabimi shtypi (pra, të një shume që duket qartë se është e gabuar), ankandi rihapet dhe Zhvilluesi i Tregut i kërkohet të korrigjojë shumën. Ky rregull nuk zbatohet për ankandin e emetimit fillestar.
8.	Shuma maksimale e alokuar tek një Zhvillues i Tregut nuk mund të jetë më e madhe se 40% e ofertës maksimale të shpallur.
9.	Shuma maksimale e pjesëmarrjes për një klient nëpërmjet secilit nga zhvilluesit e tregut nuk duhet të tejkalojë 30% të ofertës të shpallur nga Ministria në ankand. Secili zhvillues tregu është përgjegjës për respektimin e këtij limiti
10.	Gjate procedurës së pranimit të kërkesave, MFE mund të devijojë nga oferta e shpallur me maksimumin +/- 15%. Devijimi duhet të mbështetet në cilësinë e kërkesave, jo në nivelet e <i>yield</i> -eve; pra <i>yield</i> maksimal i pranuar duhet të duhet të jetë kufiri i fundit në shpërndarjen normale të serisë së <i>yield</i> eve të kërkura.
11.	Publikimi i rezultateve do të kryhet me mjetet e informimit në dispozicion të MFE dhe BSH (faqet e internetit dhe Reuters/Bloomberg) brenda orës 11.00 të datës së zhvillimit të ankandit.
12.	Gjatë ankandit konkurrues mund të paraqiten dhe kërkesa jo-konkurruese. Çdo Zhvillues i Tregut që <i>merr pjesë në ankandin konkurrues</i> ka të drejtë të blejë 100 milion lekë me kërkesë jo konkurruese, duke përfutur <i>yield</i> -in mesatar të ponderuar të kërkesave të pranuar në ankand.
13.	Shlyerja e ankandit zhvillohet në T+2.

Përditësuar datë 12.03.2019 referuar Vendimarrjes së Komitetit Market Maker (5 bankat zhvillues Tregu dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë) datë 07.03.2019

### 3.2. Detyrimet e Zhvilluesit të Tregut

- Zhvilluesi i Tregut blen minimumi 5% të obligacioneve referencë të emetuara.

Përditësuar datë 12.03.2019 referuar Vendimarrjes së Komitetit Market Maker (5 bankat zhvillues Tregu dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë) datë 07.03.2019